

Gjymtim i organeve gjenitale

Të gjitha format e gjymtimit të organeve gjenitale janë të ndaluara në Suedi sipas ligjit suedez (nr. 1982:316). Ai/ ajo që e thyen këtë ligj mund të dënohet me burgim deri në 10 vite. Po ashtu tentativat apo përgaditjet për gjymtim të organeve gjenitale përbëjnë veprë penale.

Po ashtu është në kundërshtim me ligjin që në bashkëveprim me të tjerë të vendoset për të gjymtuar organet gjenitale të një personi tjetër ose t'a bindësh dikë tjetër që ta kryej këtë veprim penal. Po ashtu marrja përsipër e kryerjes së gjymtimit të organeve gjenitale ose t'i ofrosh dikujt të kryesh gjymtimin e organeve gjenitale përbën veprë penale.

Një person mund të akuzohet për veprë penale në Suedi edhe nëse gjymtimi i organeve gjenitale është bërë në një shtet tjetër ku ky veprim nuk është i kriminalizuar. Po ashtu nuk është e mundur të japësh pëlqim për gjymtimin e organeve gjenitale. Që nga 1 maj 2020 afati i parashkrimit të veprës penale të gjymtimit të organeve gjenitale të kryer ndaj fëmijëve është hequr fare. Të gjithë e kanë një përgjegjësi që ta pengojnë gjymtimin e organeve gjenitale dhe kjo përfshin edhe prindërit. Është e dënueshme mos zbulimi i kësaj veprë penale.

Ligji (nr. 1982:316) për ndalimin e gjymtimit të organeve gjenitale të femrave

Pasojat

Gjymtimi i organeve gjenitale femërore është një sulm që ka për qëllim të ndryshojë apo të dëmtojë organet e jashtme gjenitale të një vajze apo një femre. Në disa kontekste përdoret termi syneti në vend të gjymtimit të organeve gjenitale. Gjymtimi i organeve gjenitale shkakton dëme në shumë mënyra dhe shkakton këto shqetësime menjëherë apo më vonë gjatë jetës;

- Gjakderdhje e madhe me ratsin e intervenimit
- Infeksione
- Dhimbje në organe gjenitale
- Vështirësi gjatë urinimit
- Vështirësi me rastin e ciklit menstrual
- Dhimbje gjatë marrëdhënieve seksuale, si për fëmërën ashtu edhe mashkullin
- Dëme që shkaktojnë rrezik që femra të mos mbetet shatëzënë
- Komplikime me rastin e lindjes
- Shqetësime psikologjike
- Vdekje

Tipe të gjymtimit të organeve gjenitale

Sipas WHO ka katër tipe të gjymtimit të organeve gjenitale:

- Tipi 1** Klitoris dhe / ose lëkura në klitoris hiqen (prehen).
- Tipi 2** Klitoris dhe buzët e brendshme të vulvës dhe nganjëherë edhe ato të jashtme e prehen (hiqen).
- Tipi 3** Syneti faraonike. Klitoris dhe buzët e brendshme dhe të jashtme të vulvës prehen dhe qepen ashtu që të mbulohet vrima e vaginës.
- Tipi 4** Të gjitha llojet e tjera të intervenimeve si për shembull bëhet shpuarja e klitorisit dhe e indeve përreth me një mjet të mprehtë që i dëmton organet gjenitale. Kjo quhet shpuarje.

Gjymtim i medikalisuar: Është gjymtimi i organave gjenitale që kryhet nga personeli shëndetësor. Edhe nëse kjo kryhet jashtë shtetit prapë se prapë përbën veprë penale sipas ligjit suedez.

Sunna: Nganjëherë përmendet fjala “sunna” kur flitet për lloje të nryshme të gjymtimeve të organeve gjenitale, edhe “sunna” është në kundërshtim me ligjin.

A kërkon ti apo dikush tjetër që ti e njeh ndihmë?

Nëse ti je e shqetësuar se ti apo dikush në afërsinë tuaj rrezikon t'i ekspozohet gjymtimit të organave gjenitale në Suedi apo jashtë vendit, ti mund t'a kontaktosh qendrën për punë sociale, kujdestarinë e socialit ose policinë në qytetin ku banon ti dhe u'a shpreh shqetësimin tënd.

Komuna e juaj

Në uebsajtin e komunës suaj gjenden të dhënat e kontaktit të qendrës për punë sociale dhe kujdestarisë së socialit. Kujdestarinë e socialit mund ta kontaktoni edhe përmes SOS Alarm 112 nëse nuk ke mundësi të kërkosësh numrin e telefonit të tyre. **Ti gjithmonë mund të telefonosh dhe të mbetesh anonime kur i telefonon qendrën për punë sociale apo kujdestarisë së socialit.**

Policia

Nëse rasti është emergjent ti duhet t'i telefonosh policisë në 112. Për raste të tjera telefono në numrin 114 14, dhe nga jashtë shteti numri është +46 77 114 14 00.

Ministria e punëve të jashtme - MPJ

Nëse ti gjendesh jashtë Suedisë dhe ke frikë për gjymtim të organeve gjenitale ti duhet ta kontaktosh ambasadën suedeze ose konsulatën në atë shtet ku ndodhesh ti. Ambasada dhe Ministria e Punëve të Jashtme mund të shikoj nëse ka diçka që mund të bëhet që ti të kthehesh në Suedi. Lista e ambasadave të Suedisë gjendet në uebsajtin swedenabroad.se. **Ti mund t'i telefonosh edhe kujdestarisë së MPJ në numrin e telefonit +46 (0) 8 - 405 50 05. Kujdestria e MPJ-së është e hapur 24 orë, çdo ditë.**

Nationellt centrum | mot
hedersrelaterat
våld och förtryck



Polisen

Sipas ligjit suedez (SFS 1982:316)

Ky material është hartuar nga Qendra kombëtare kundër dhunës dhe shtypjes referuar ruajtje së nderit

According to Swedish law (SFS 1982:316)

INFORMATION OM KÖNSSTYMPNING

Albanska



Sverige